



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 04.04.2023

Nr: 48

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 44, DATË 31.03.2023 TË DEPOZITUAR NGA PARTIA  
“ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, përfaqësuar nga kryetari  
z. Zef Bushati;

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 12, datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 6 të  
bashkisë Vau i Dejës, Shkodër

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “c”, 124, 133-136 të ligjit nr. 10019, datë  
29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, konstatoi

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 për “Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, partia “Aleanca DemoKristiane e Shqipërisë” ka depozituar në datën 27.03.2023, në KZAZ nr. 06 të bashkisë Vau i Dejës, dokumentacionin e për regjistrimin e listës shumëmemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.
3. KZAZ nr. 06 e bashkisë Vau i Dejës, pasi konstatoi parregullsi në dokumentacionin e paraqitur, përkatësisht në renditjen e kandidatëve në listën shumëmemërore ku nuk ishte zbatuar dispozita e kuotës gjinore, e rikthen listën për korrigjim, duke i lënë afat subjektit zgjedhor për ridepozitimin e listës së korrigjuar brenda 48 orësh.
4. Subjekti ankues pretendon se Kryetari dhe anëtarët e KZAZ-së nr. 06, Vau i Dejës, nuk kanë pritur të ridepozitohet lista e korrigjuar por kanë marrë vendim për mosregjistrim të saj për shkak parregullsie të dokumentacionit. Për këtë arsye ka paraqitur kërkesën ankimore pranë KAS, me anë të së cilës kërkon ndryshimin e vendimit nr. 12, datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 06, Vau i Dejës dhe regjistrimin e kandidatit z. Zef Bacaj për anëtar Këshilli Bashkiak të partisë “Aleanca DemoKristiane e Shqipërisë”.
5. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvin Lako. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 04.04.2023, ora 12:40. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankimuese, përfaqësuar nga z. Zef Bushati dhe kryetari i K.Z.A.Z nr. 6, Bashkia Vau i Dejës z. Sokol Shkreli.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 44, datë 31.04.2023
- Vendimin nr. 12, datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 06, Vau i Dejës
- Librin e Protokollit të mbajtur nga anëtarët e KZAZ nr. 06

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

**KAS-i konstatoi:**

1. Referuar parashikimeve të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 67, pikat 1 dhe 2, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendor, së bashku me dokumentet e kandidimit, depozitohen dhe regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore.

Neni 73 i Kodit, ashtu dhe neni 12 i Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përcaktojnë se KZAZ-ja, pasi merr në dorëzim dokumentacionin përkatës verifikon rregullsinë e tij dhe nëse vëren parregullsi apo mospërbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Dokumentacioni i korrigjuar më pas depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.

2. Në rastin objekt shqyrtimi, partia “Aleanca DemoKristiane e Shqipërisë” ka depozituar në datën 27.03.2023, në KZAZ nr. 06 të bashkisë Vau i Dejës, dokumentacionin e për regjistrimin e listës shumëmemërore të partisë për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak. KZAZ nr. 06 e bashkisë Vau i Dejës, pasi konstatoi parregullsi në dokumentacionin e paraqitur, përkatësisht në renditjen e kandidatëve në listën shumëmemërore ku nuk ishte zbatuar dispozita e kuotës gjinore, e rikthen listën për korrigjim, duke i lënë afat subjektit zgjedhor për ridepozitimin e listës së korrigjuar brenda 48 orësh.

3. Në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, anëtarët e KZAZ-së nr. 06, nuk pritën subjektin zgjedhor të ridepozitonte dokumentet e korrigjuara, por proceduan me nxjerrjen e vendimit nr. 12, datë 28.03.2023 duke mos regjistruar listën shumemërore të subjektit për arsye dokumentacioni të parregullt.
4. Në asnjë rast, Kodi nuk parashikon mundësinë e KZAZ për të refuzuar marrjen në dorëzim të dokumentacionit; edhe nëse nga ana e KZAZ pretendohen parregullsi.

Në rastin konkret, anëtarët e KZAZ-së nr. 06 në bashkinë Vau i Dejës, kanë vepruar në kundërshtim me kompetencat e dhëna shprehimisht nga ligji, duke mos respektuar procedurën dhe afatin për ridepozitim të listës shumemërore të korrigjuar pas konstatimit të të metave të saj.

Kjo KZAZ do duhej të merrte në dorëzim dokumentacionin e ridepozituar nga partia “Aleanca DemoKristiane e Shqipërisë” dhe më pas mund të vendosë për regjistrimin ose mosregjistrimin e listës shumemërore të subjektit zgjedhor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, KAS

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 44, datë 31.03.2023, të paraqitur nga “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
2. Detyrimin e KZAZ-së nr. 6 të shqyrtojë dhe regjistrojë listën shumemërore për anëtarë të këshillit të Bashkisë Vau i Dejës, të subjektit “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Elvin LAKO - Relator**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**